

Miran Kopani

Miran Kopani u lind Tiranë më 27.05.1971. Në vitet 1990-1995 ka studiuar në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Në vitet 1996-1998 ka punuar si jurist në Drejtorinë Ligjore pranë Departamentit të Shtetit të Postave dhe Telekomunikacionit. Në vitin 1998 deri në vitin 2000 ka punuar si jurist pranë Bankës Kombëtare Tregtare. Në vitin 2000 ka nisur punën si specialist pranë Drejtorisë së Organizimit Gjyqësor dhe specialist pranë Drejtorisë së Legjislacionit dhe dhe Asistencës Ligjore, në Ministrinë e Drejtësisë deri në vitin 2008. Më pas, është emëruar Drejtori i Legjislacionit dhe Asistencës Ligjore, Departamenti i Përgjithshëm i Kodifikimit, në këtë Ministri, deri në vitin 2010. Po në këtë vit ka marrë detyrën e Drejtorit të Studimeve Ligjore, Publikimeve dhe IT, pranë Gjykatës së Lartë, të cilën e ka ushtruar deri në vitin 2014. Prej vitit 2014 e në vazhdim mban detyrën e Këshilltarit Ligjor, në Kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë.